30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jetë informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovimi.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimi përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprejë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;

- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundur. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 30 % e çmimit total të kontratës, nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës me validitet prej 90 ditë.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : 2 (Dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës –60 ditë kalendarike, ose deri me date 26.10.2020.
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë.

		Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni I Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues Menagjer I kontrates nga AK është: Bean Haxhiasani Menagjer I projektit nga AK është : Florim Krasniqi Menagjer I projektit nga OE është: Selman Muharremaj
Pagesa	24.2	Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit deri në 70 % të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: [shëno përqindjen]
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së

mosmarrëveshjeve		Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi

1168 - Pllovë

Kubëzimi, kanalizimi dhe rregullimi i parkut në fshatin Plavë					
A RREGULLIMI I PARKUT S= 1400 m2					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit . Kompania punë kryese është përgjegjëse për të marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitetet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar të kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
1	PUNËT PREGADITORE				
1.1	Shënim i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet parku me infrastrukturën përcjellëse sipas projektit detal .gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m2	m2	1400.00	0.20 €	280.00 €
1.2	Identifikimi instalimeve nëntoksor dhe mbiotoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piktetimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimitin parandalimit dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e teranit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin parkut dhe infrastrukturës përcjellëse. Llog në m2	m2	1400.00	0.20 €	280.00 €
1.3	Punët parapërgatitore, shënim i parkut ,shutigjeve, si dhe elemente përcjellëse në bazë të projektit zbatues. Në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike.	m2	1400.00	0.30 €	420.00 €
1.4	Ekzaminimi i materialeve para dhe pas vuajtjes në vepër të tyre si psh. kallidrenit, porfidos, kubëzave elementeve të tjera për shqyrtim si dhe preardhjen e tyre. Kontraktori është i obliguar që të sjellë ateste paraprake dhe preardhjen e materialit para fillimit të punimeve.	komplet	1.00	100.00 €	100.00 €
Gjithsej: Pos 1					1,080.00 €
2	PUNIMET TOKËSORE				
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
2.1	Pastrimi i terrenit nga mbeturinat e ngurta, shkurret dhe drunjtë si dhe largimi i shtresës humusore ne trashësi deri ne 20 cm ne tere sipërfaqen e parkut. Në çmimi kalkulohet pastrimi i zonës , kthimi në gjendjes të më parshme , ngarkimi dhe transportimi deri në Deponin e qytetit Dragashit. Llogarite në m2	m2	1400.00	1.00 €	1,400.00 €
2.2	Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV për punimin e shkalleve, platformes , fontanës, kendit te lojrave dhe shtegut. Dheu te ruhet per perdorim te mevonshem per mbushjen dhe e pjeseve te caktuara ne projekt. Ne llogari të merret edhe transporti i dheut te tepërt deri në deponi më se largu 5 km sipas udhëzimeve të investitorit dhe mbikqyrësit.	m3	200.00	1.00 €	200.00 €
2.3	Gërmimi i dheut (themeleve të caktës rrethojës) i kategorisë së III- IV-të me makina ndërtimore dhe me vegla dore, materiali i tepërt i cili mbetet pas mbushjes deponohet me transport në deponinë të cilën e cakton investitori .Llog. Në m3	m3	160.00	1.00 €	160.00 €
2.4	Ngjeshja e dheut ne tere sipërfaqet ku do të punohet shkallët , platforma, kendit i lojrave, fontanës si dhe shtegut të ecjes pas gërmimit ne te njejtin nivel. Ngjeshja te behet me cilindër deri sa te arrihet ngjeshmeria 40KN/m2. Ne kete pozicion te kalkulohet edhe vendosja e shtreses gjeo-tekstil per stabilizimin e teranit.	m2	400.00	1.00 €	400.00 €
2.5	Ngjeshja e dheut ne bazamentin ku do të vendoset rrethoja , ngjeshja bëhet me papuqe vibruese. Llog në m2	m3	160.00	1.00 €	160.00 €
2.6	Gërmimi i sipërfaqeve të gjelbruara largimi i burit të thatë , si dheut pasiv të papërshtatshë për rikultivimin e barit , dheut i gërmuar së bashku me vegetacioni largohet në deponin e afërt.	m2	400.00	1.00 €	400.00 €
Gjithsej: Pos 2					2,720.00 €

PUNIMIET E MBUSHIJES (TAMPONI)					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së shkallët, platforma, kendi i lojtrave, fontanës, shtegut të cejes si dhe bazamentit të rrethojës, nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=650 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet të jetë i paisur me ateste paraprake ,dhe atë sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës shtigjeve të cejes dhe pllatoës me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=10cm	m3	40.00	5.00 €	200.00 €
	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së shkallët, platforma, kendi i lojtrave, fontanës, shtegut të cejes si dhe bazamentit të rrethojës, nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 32) mm me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet të jetë i paisur me ateste paraprake ,dhe atë sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës të shtigjeve të cejes dhe pllatoës me gurë të thyer fraksion 0-32 mm t= 10 cm	m3	40.00	5.00 €	200.00 €
	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës trafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 , në zonat ku do të vendosën kubëzat, pllaka betoni në pllato dhe shtigje të cejes .Sqarim: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës të shtigjeve të cejes dhe pllatoës me gurë fraksion 0-4 mm t= 5 cm, në çmim përfshihet edhe shtrimi i gjeotekstilit për mbrojtjen e rrës mos shkapërderdhet.	m3	20.00	6.00 €	120.00 €
			Gjithsej: Pos 3		520.00 €
PUNIMIET E MBISTRUKTURËS PARKUT					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
4.1	Furnizimi , transporti dhe vendosja e pllakave njeshitresore nga graniti dhe mermeri me granit natyral (Granit, Diabaz, Bazalt)etj. me ngjyre te zeze me granulat granit nero 2-4 mm sipas detalit ne projekt të cilat vendosen në shkallët e parkut dhe shtegut ne hyrje te shkalleve dhe ne dalje te tyre. Pllaka terastone eshte me dimensione 330x330x48mm e kalibruar,e gerryer, e rrezuar dhe impregnaur me tehe chamfer. Ne vlera referuese te Standardeve Evropiane EN 13748-2:2004. Prodhuesi te jete i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per system hermetik te makinerise prodhuese. Produkti te plotesoj standardet ne vazhdim: EC (Declaration of Conformity) Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD(Construction Product Directive) dhe EN 13748 Materiali duhet të posedoj ateste të çertifikuara me shenjen CE. Në çmim llogaritet të gjitha shpenzimet , vendosjen e pahive dhe përforcimi anash me beton në të dy anët e shkallëve.	m2	32.00	20.00	640.00 €
4.2	Furnizimi , transporti dhe vendosja e pllakave në formë mozaiku njeshitresore nga graniti dhe mermeri me granit natyral (Granit, Diabaz, Bazalt)etj. me ngjyre te zeze me granulat granit nero 2-4 mm sipas detalit ne projekt të cilat vendosen në pllatoe e qeshmës. Pllaka terastone eshte me dimensione 400x400x48mm e kalibruar,e gerryer, e rrezuar dhe impregnaur me tehe chamfer. Ne vlera referuese te Standardeve Evropiane EN 13748-2:2004. Prodhuesi te jete i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per system hermetik te makinerise prodhuese. Produkti te plotesoj standardet ne vazhdim: EC (Declaration of Conformity) Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD(Construction Product Directive) dhe EN 13748 Materiali duhet të posedoj ateste të çertifikuara me shenjen CE. Në çmim llogaritet të gjitha shpenzimet , vendosjen e pahive dhe përforcimi anash me beton në të dy anët .	m2	25.00	20.00	500.00 €

4.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e pllakave njeshtresore me stimulim rrasa gurit, pllaka është nga graniti dhe mermeri me granit natyral (Granit, Diabaz, Bazalt) etj. me ngjyre te zeze me granulat granit nero 2-4 mm sipas detalit ne projekt te cilat vendosen ne shtigjet e ecjes. Pllaka terastone eshte me dimensione 500x500x50mm e kalibruar, e gerryer, e rrezuar dhe impregnaur me tehe chamfer. Ne vlera referuese te Standardeve Evropiane EN 13748-2:2004. Prodhuesi te jete i certifikuar sipas ISO 9001/2015 (Sistemi per menaxhimin e cilesise) per system hermetik te makinerise prodhuese. Produkti te plotesoj standardet ne vazhdim: EC (Declaration of Conformity) Produkti te posedoj shenjen CE ne perputhje me direktivat per CPD(Construction Product Directive) dhe EN 13748 Materiali duhet te posedoj ateste te certifikuara me shenjen CE. Ne çmim llogaritet te gjitha shpenzimet, vendosjen e pahive dhe përforcimi me llac ngjites dhe përforcimi beton ne te dy anet.	m2	130.00	10.00	1,300.00 €	✓	
4.4	Te llogaritet edhe mbushja e fugeve me material HUESLER, Baunit apo te ngjashme me efekt jodrenues apo te ngjashem sipas EN 13888. Sasia e nevojshme e llogaritur 0.7 kg/m2	m2	140.00	4.00	560.00 €	✓	
4.5	Furnizimi, transporti dhe shtruarja e anësoreve te shtegut te rrafshet me anësore nga betoni me dim : 80x200x1000 mm sipas detalit teknik te përfshirë ne projekt. 1.log për m' me te gjitha shpenzimet, vendosjen e pahive përforcimin me beton.	m'	150.00	6.00	900.00 €	✓	
4.6	Furnizimi, transporti dhe shtruarja shkallareve pran kendit te lojrave me dysheme nga derrasat t= 5 cm nga druri INPREGNUET (i zier) nga pisha apo bungu si dhe punimi i shkallareve dhe 2 shtyllave per loje sipas projektit. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet e nevojshme per punimin e ketij pozicioni duke përfshirë edhe lyrjen dy shtresore me ngjyre yndyrshme dy komponentet për mbrojtjen ndaj ndikimeve klimative, UV dhe inskteve.	m2	55.00	7.00	385.00 €	✓	
4.7	Furnizimi, transporti dhe shtruarja e pllatformës me disnivele dhe shkallëve te saj me dysheme druri nga druri INPREGNUET (i zier) t= 5 cm, sipas detalit ne projekt. Ne kalkulim te perfshihen te gjitha materialet e nevojshme per punimin e ketij pozicioni duke përfshirë edhe lyrjen dy shtresore me ngjyre yndyrshme dy komponentet për mbrojtjen ndaj ndikimeve klimative, UV dhe inskteve.	m2	30.00	5.00	150.00 €	✓	
4.8	Furnizimi me material dhe punimi i gomes ne kendet e lojrave. Punimi i dyshemesë nga goma me shtresë te dyfishtë : sistemi me spërkatje (spraycoat). Struktura bazë te jetë e punuar nga granulata SBR -gomë e recikluar 1-3,5 mm, e ngjitur me ngjitës adekuat dhe shtresa e epërme me stërpikje me poliuretane dhe granula EPDM :0,5 - 2,5 mm dhe EPDM puder 0.0 -0,5mm-dy herë. Produkti te plotesojë standardet DIN V 18035-6, EN-14 977, IAAF ose te ngjajshme. Trashësia e tërë shtresave min. 13 -14 mm.Të gjitha shtresat e dyshemesë te jenë sistem i një prodhuesi duke përfshirë edhe ngjitësat adekuat. Ky pozicion te realizohet me demos nga stafi profesional i trajnuar për realizim të produktit dhe ne tërësi sipas ndihëzimeve të prodhuesit (temp. minimale dhe temp. maksimale gjatë realizimit, lagështia e ajrit, vret Uv etj.)përfshirë edhe pastrimin paraprak të buzës dhe pregaditjen e nënbazës. Të ofrohet garancia në prodhim/material (min. 5 vite) dhe në realizim (min. 3 vite). Obligim i punëkryesit është sigurimi i materialit dhe prodhimit gjatë realizimit dhe mbrojtja nga ndikimet atmosferike (të reshurat, dielli etj.). Kjo dysheme punohet te fusha e sportit dhe shtegu për jogging. Punëkryesi gjatë ofertimit të prezantojë katalogun e materialit - prodhuesit dhe metodologjinë e realizimit. Pozicioni llogaritet me çmim njësi.	m2	260.00	5.00	1,300.00 €	✓	
				Gjithsej: Pos 4		5,735.0	✓
5	PUNIMET E BETONIT						
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total TVSH (€)		
5.1	Betonimi i bazamentit platformës, fontanës dhe këndit rëmijve						

5.1.1	Punimet e kallupimit, sjellja e betonit, hudhja e betonit ne pozicion, betonimi, armimi, mirëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve per punimin e bazamentit së platformes, fontanes dhe bazës së këndit të lojrave dhe shtigjeve, me trashësi $t=15\text{ cm}$. Rrafshimi duhet te behet me makina perkatese. Në qmim përfshihet -Shtuerja e shtresës nga betoni i armuar me trashësi 15cm me armaturë rrejtë Q-335 (betoni dhe rrjetat janë e llogaritur ne pozicionet e meposhtme) duke punuar dilatatimet e nevojshme me modul 24m ² (për kënde te lodrave). Betonit ti shtohet aditivi për rezistencë ndaj lageshtisë.Ti kushtohet kujdes nivelimit dhe evitimit të gropave dhe deformimeve gjatë betonimit.	m2	85.00	50.00	4.250,00 €
Gjithsej: Pos 5					4.250,00 €

MOBILARI URBAN					
Nr.rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Lodrat në hapësirë të hapur. Paisjet të jenë të prodhuara fabrikisht nga prodhuesi i specializuar në këtë lloj të prodhimit me produkte të kualitetit të lartë me ateste të posaçme të shfrytëzimit të produktit , me funksionalizim, dizajn atraktiv dhe rezistencë të madhe ndaj vandalizmit dhe kushteve atmosferike. Të gjitha paisjet të jenë të punuara sipas standardeve ISO 14001 dhe ISO 9001. Produkti të mos përmbajë kimikale të dëmshme. Çdo paisje të përmbajë udhëzimin e përdorimit dhe përshkrimin e funksioneve . Konstruksioni bazë i produkteve të jetë nga çeliku, të mbrojtura me ngjyrë ekologjike me sistem pudër ose zallim. Çmimi përfshin furnizimin, transportin dhe montimin në tërësi sipas udhëzimit të prodhuesit. Ofertuesi të prezantojë katalogje të prodhuesit të specializuar.					
